


Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Autoriteti i Konkurrencës
Autoritet za Konkurenciju - Competition Authority



Vendimi Nr.93/23
Datë: 11.10.2023

Duke u bazuar në nenin 11, 13, 15, 16, 17, 18, 26, 27 dhe 55 par 1.5 të Ligjit Nr. 08/L-056 Për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, Për Mënyrën e Paraqitjes së Kërkesës dhe Kriteret për Konstatimin e Përqendrimit të Ndërmarrjeve dhe Udhëzimit Administrativ Nr. 01/2023 Për Mënyrën e Përcaktimit të Tregut Relevant, Komisioni i Autoritetit të Konkurrencës i Republikës së Kosovës në mbledhjen e datës 11.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. LEJOHET. Përqendrimi i ndërmarrjeve lidhur me blerjen e aksioneve nga Viva Fresh Sh.p.k., (blerës) mbi KIT-GO DOEEL Shtip Trading Company (shitës).

Viva Fresh Sh.p.k., është kompani e themeluar dhe e regjistruar në Republikën e Kosovës, me numër të regjistrimit të biznesit 810670390, me adresë në Magjistranja Prishtinë Lipjan NN, Suhadol, Graçanicë, Kosovë.
Aktiviteti i kompanisë është: shitja me pakicë e mallrave në dyqane – supermarkete jo të specializuara.

KIT-GO DOEEL Shtip, është shoqëri tregtare e themeluar dhe regjistruar në Maqedoninë e Veriut, me numër të regjistrimit të biznesit 4333314, me seli në Bul Goce Dellçev nr. 52 Shtip.
Aktiviteti i biznesit është: tregtia me pakicë në dyqane të specializuara.

II. Parashtruesi i njoftimit për Përqendrim obligohet të paguaj taksën administrative prej 1000.00 €, me shkronja (njëmijë euro), dhe Autorizimin për Realizimin e Përqendrimit në përputhje me nenin 18 të ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës dhe neni 24 të Udhëzimit Administrativ Nr. 02/2023, bëhet kundrejt pagesës në vlerë prej 6,000.00 € me shkronja gjashtë mijë Euro.

Arsyetim

Autoriteti i Konkurrencës i Republikës së Kosovës me datë: 21.08.2023, me Nr. Prot. 391/23-01/H ka pranuar Kërkesën për Lejim të Përqendrim lidhur me blerjen e aksioneve nga Viva Fresh Sh.p.k., (blerës) mbi KIT-GO DOEEL Shtip Trading Company (shitës).

Procedurat e ndjekura:

1. Vlerësimi i Lëndës
2. Vërtetimi për Kërkesën e Dorëzuar me datë 15.09.2023
3. Njoftimit për realizimin e përqendrimit në web faqen e AKRK-së me datë 18.09.2023
4. Më datë 24 Janar 2023, palët kanë nënshkruar Marrëveshjen për Blerjen e Aksioneve ndërmjet Viva Fresh Sh.p.k (blerës) mbi KIT-GO DOEEL Shtip Trading Company (shitës).

Baza juridike;

Sipas nenit 13, të Ligjit nr. 08/L-056 për Mbrojtjen e Konkurrencës, nga dokumentacioni i prezantuar në dosjen e lëndës, palët përmbushin detyrimin për të bërë njoftimin e Përqendrimit pasi që;

- a) Qarkullimi i kombinuar i palëve në tregun ndërkombëtarë e kalon shumë më 20,000,000 Euro.
- b) Qarkullimi i një pale në Përqendrim e kalon shumë më 1,000,000 Euro.
- c) Parashtruesit e kërkesës kanë për qëllim të ekzekutojnë Marrëveshjen për blerjen e aksioneve të lidhur me datë 24 Janar 2023.
- d) Kontrata e nënshkruar ndërmjet palëve, datë 24.01.2023.
- e) Kërkesa për përqendrim, është bërë për arsye se Aplikuesi është ndërmarrje vendore e regjistruar në Republikën e Kosovës.

Analiza e Konkurrencës

Transaksioni i propozuar, ka të bëjë me blerjen e aksioneve mbi kompanin KIT-GO DOEEL Shtip, e cila operon në sektorin e shitjeve me pakicë - supermarketeve në territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe e cila pas mbylljes së transaksionit dhe të gjitha obligimeve kontraktuale do të jenë pjesë e rrjetit të supermarketeve Viva Fresh Sh.p.k., kjo ndërmarrje nuk ka ndonjë prezencë në Kosovë, qoftë ndonjë filiale apo përmes shitjeve, ndërsa pala blerëse është kompani e vendore, e themeluar dhe regjistruar sipas ligjeve të Republikës së Kosovës e cila poashtu operon në sektorin e shitjeve me pakicë - supermarketeve duke përfshirë një rrjet të madh të shitjeve me pakicë në Kosovë, me rreth mbi 110 dyqane në 32 qytete të Kosovës. Në bazë të analizave të kompanisë, Viva Fresh llogaritet të ketë një strukturë tregu prej 13%. Tregu për ofrimin e shitjeve me pakicë – supermarkeve në Republikën e Kosovës është treg mjaftë konkurrues pasi ka një numër të madh të kompanive që kanë rrjete të

supermarketeve në tërë territorin e Republikës së Kosovës dhe më gjerë. Prandaj sa i përket shkallës së koncentrimit në këtë sektor mund të themi që është mjaftë i ulët. Transaksioni si i tillë nuk do ndikojë në tregun e Kosovës, pra nuk do të kufizoj apo do të shtrembëroj konkurrencën në tregun përkatës, transaksioni i propozuar nuk mund të forcoj asnjë pozitë dominues në treg, për më tepër, meqenëse targeti nuk ka prezencë, tregu i Kosovës mbetet i pa ndikuar nga ky transaksion.

Tregjet Relevante dhe Vlerësimi i Konkurrencës

Tregu relevant, përcaktimi i tregut relevant mund të lihet i hapur.

Tregu i Produktit, tregu i shitjes me pakicë së mallrave të konsumit në dyqane – supermarketë jo të specializuara në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

Tregu gjeografik, do të përcaktohet tregu kombëtar.

Efektet e konkurrencës në tregun përkatës nga transaksioni i realizuar

Transaksioni i propozuar do të realizohet në tregun gjeografik të Republikës së Maqedonisë së Veriut. Kërkesa për Njoftimin e Përqendrimit është bërë për arsye se Aplikuesit Viva Fresh Sh.p.k., e cila synon ta blejë targetin është kompania vendore e cila ka një shtrirje në tërë Republikën e Kosovës duke ofruar një gamë të gjerë të produkteve për konsumatorët vendorë. Sipas vlerësimit të përqendrimit, transaksion nuk do të ketë efekte negative për Konkurrencën e rrjedhshme për konsumatorët në Republikën e Kosovës. Nga të dhënat e ofruara konsiderojmë se implementimi i transaksionit nuk ka mundësi të kufizimit ose shtrembërimit të konkurrencës në treg.

Autoriteti i Konkurrencë ka vlerësuar se transaksioni nuk paraqet efekte negative, në konkurrencë për arsye se ky transaksion /blerja nuk ndikon në forcimin e pozitës dominues të ndërmarrjes blerëse, tek operatorët ekonomik apo konsumatorët

Shënim;

Çdo formë e shtrembërimit të konkurrencës, respektivisht sjellje anti - konkurruese do të jetë nën monitorimin e Autoritetit Kosovar të Konkurrencës.

Kërkesa për Përqendrim, merr epilogun si në dispozitiv të këtij VENDIMI.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

KOMISIONI I KONKURENCËS

Kaltrina Sela
Zv. Kryetare



Neime Binaku-Isufi
Kryetare



Nafije Osdautaj
Anëtare



III. Me këtë Vendim të njoftohen:

- Palët
- Arkiva